FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

KLORUR NATRIUMI

Tretësirë për injeksion – 1000 mg / 10 ml (10 %)
Tretësirë për injeksion – 85 mg / 10 ml (0.85 %)
Tretësirë për perfuzion – 0.9%
(Klorur natriumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Klorur natriumi dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Klorur natriumi
3. Si ta merrni Klorur natriumi
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Klorur natriumi
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KLORUR NATRIUMI DHE PËRSE PËRDORET

Klorur natriumi është një produkt farmaceutik që ka si lëndë aktive klorurin e natriumit. Kloruri i natriumit bën pjesë në grupin e madh të elektrolitëve. Ai është përdorur në menaxhimin dhe rregullimin e defiçitit të joneve të natriumit dhe klorit në kushtet e një humbjeje të madhe të kripërave.
Tretësirat e kripërave të natriumit përdoren si burim i klorurit të natriumit dhe ujit për hidratim. Një tretësirë 1000 mg / 10 ml (10 %) është hiperosmotike.

2. PËRPARA SE TË MERRNI KLORUR NATRIUMI

Mos merrni Klorur natriumi:
- në rastet e një mbihidratimi;
- në pamjaftueshmëri të rëndë të funksionit të veshkave;
- në qoftë se jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të barit, pasi mund të shfaqen reaksione alergjie;
- në rastet e hipernatremisë, hiperkloremisë;
- në rastet kur përdorimi i natriumit ose i klorit mund të jetë i dëmshëm nga ana klinike.

Tregoni kujdes të veçantë me Klorur natriumi
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Klorur natriumi
Sasitë e mëdha të klorurit të natriumit, të marra me çfarëdo rruge mund të shkaktojnë hipokalemi dhe acidozë.
Përdorimi i Klorur natriumi duhet bërë me kujdes në të sëmurët me dëmtim të funksionit të veshkave, në pamjaftueshmëri të funksionit të zemrës, në hipertension, në edemë periferike dhe pulmonare, në toksemi të shtatzënisë, në cirrozë hepatike dhe gjendje të tjera të lidhura me mbajtjen e natriumit.
Duhet treguar kujdes nëse përdoret tek fëmijët apo të moshuarit.
Tretësira me përqëndrim të klorurit të natriumit më të lartë se 0.9% (tretësirë hipertonike) duhet përdorur me kujdes, me shpejtësi të kontrolluar dhe vetëm në rastet kur është qartësisht e indikuar.
Në pacientët që përdorin barna kortikosteroidë ose kortikotropikë, kloruri i natriumit duhet përdorur me shumë kujdes.
Gjatë perfuzionit është mirë të kontrollohet bilanci i lëngjeve, i elektrolitëve, osmolariteti plazmatik dhe ekuilibri acido-bazik.

Marrja e barnave të tjera
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.

Për të minimizuar rrezikun e papajtueshmërive të mundshme që mund të shfaqen nga përzierja e tretësirës për perfuzion Klorur natriumi me tretësira të tjera, duhet vërejtur me kujdes përzierja përfundimtare para injektimit dhe periodikisht gjatë përdorimit, për mundësinë e ndonjë turbullire ose fundërrese.

Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:
- kortikosteroidë, sepse ata shoqërohen me mbajtje të natriumit dhe ujit duke dhënë edema dhe hipertension, kështu që nevojitet shumë kujdes nëse administrohen njëkohësisht kortikosteroidë dhe kripëra të natriumit;
- glukozë dhe fruktozë për rregullimin e nivelit të elektrolitëve;
- manitol dhe acetat natriumi në tretësirat diuretike, në kirurgjinë e kataraktit, në dëmtimin e funksionit të veshkave;
- klorur kalçiumi dhe klorur kaliumi për trajtimin e problemeve në tretje;
- bikarbonat natriumi në komë diabetike;
- klorur kaliumi, klorur magnezi gjatë kirurgjisë së zemrës;
- sulfat natriumi, sulfat magnezi, sulfat kaliumi dhe klorur kaliumi në kurimin e kapsllëkut.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.
Kujdes i veçantë duhet treguar në gratë që vuajnë nga toksemia gjatë shtatzënisë.
Përdorimi i këtij bari gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gji është i lejuar nën kontrollin e mjekut.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Ky bar nuk ka ndikim mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineri.

3. SI TA MERRNI KLORUR NATRIUMI

Gjithmonë ndiqni udhëzimet e mjekut tuaj me përpikmëri se si ta përdorni këtë bar.
Pyesni mjekun apo farmacistin tuaj nëse jeni të pasigurt.

Kloruri i natriumit, tretësirë e injektueshme jepet në mënyrë parenterale (intravenoze).
Për një të rritur, kërkesat ditore për natrium dhe klor mund të plotësohen nga perfuzionimi i 1 L tretësirë për perfuzion Klorur natriumi 0.9 % (154 milibarazvlerës natrium dhe 154 milibarazvlerës klor).

Në qoftë se keni marrë më shumë Klorur natriumi
Në qoftë se keni marrë më shumë Klorur natriumi se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Efektet anësore që ndodhin nga mbidozimi i Klorur natriumi janë efektet më serioze të hipernatremisë, si: dehidratimi i trurit, i cili mund të shkaktojë përgjumje, çoroditje që përparon në konvulsion, koma, insufiçiencë në frymëmarrje dhe vdekje.

Në qoftë se harroni të merrni Klorur natriumi
Në qoftë se harroni një dozë Klorur natriumi, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Klorur natriumi mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Injektimi i dozave të mëdha mund të shkaktojë:
- akumulim të natriumit (hipernatremi) dhe edema;
- acidozë (si pasojë e akumulimit të joneve klor).

Efektet anësore që mund të shfaqen gjatë përdorimit intravenoz janë: hipervolemi, hipotension, drithërima, ethe, reaksione lokale, dhimbje e lokalizuar, parestezi, reaksione të lëkurës, tremor, irritim vaskular, trombozë venoze, infeksion në vendin e administrimit.

5. SI TA RUANI KLORUR NATRIUMI

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni tretësirën Klorur natriumi pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban tretësira për injeksion Klorur natriumi 1000 mg / 10 ml (10%)
Lënda aktive është klorur natriumi.
Çdo ampulë 10 ml përmban 1000 mg klorur natriumi.
Lënda ndihmëse është: ujë për injeksion.

Çfarë përmban tretësira për injeksion Klorur natriumi 85 mg / 10 ml (0.85%)
Lënda aktive është klorur natriumi.
Çdo ampulë 10 ml përmban 85 mg klorur natriumi.
Përbërësit e tjerë: ujë për injeksion.

Çfarë përmban tretësira për perfuzion Klorur natriumi 0.9%, shishe qelqi
Lënda aktive është klorur natriumi.
1 ml tretësirë për perfuzion përmban 9 mg klorur natriumi.
Lënda ndihmëse është: ujë për injeksion.

Çfarë përmban tretësira për perfuzion Klorur natriumi 0.9%, qese plastike
Lënda aktive është klorur natriumi.
1 ml tretësirë për perfuzion përmban 9 mg klorur natriumi.
Lënda ndihmëse është: hidroksid natriumi dhe ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Tretësira për injeksion Klorur natriumi:
kuti me 10 ampula.

Tretësira për perfuzion Klorur natriumi:
shishe qelqi 100 ml, 250 ml, 500 ml.
qese plastike 100 ml, 250 ml, 500 ml,

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Nëntor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.